



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË MJEDISIT

Nr. 3634 Prot.

Tiranë, më 15.4. 2019

Nr. Identifikimi 311

Vendimi 18

**DEKLARATË MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Person juridik:** "ALBPETROL" sh.a.  
**Nr. NIPT-i:** J82916500U  
**Adresa e selisë:** L.29, Marsi, Patos, Fier  
**Personi përgjegjës:** Dritan Spahiu

Për të zhvilluar projektin: "Nxjerrja e naftës"

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", 14. Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror për qëllime tregtare, ku masa e nxjerrë e tejkalon nivelin prej 50 tonë/ditë në rastin e naftës dhe 10 000 m<sup>3</sup>/ditë në rastin e gazit.

**Vendndodhja:** Cakran-Mollaj, Qarku Fier

**Sipërfaqja produktive:** 950 ha

**Trashësia e katit naftëmbajtës:** 800 m

**Konsumi vjetor i energjisë:** 813000 Kwh/vit

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:**

**Drejtoritë Teknike të Ministrisë së Mjedisit shprehen:** subjekti nuk ka marrë parasysh kërkesat e drejtorive teknike të Ministrisë në fazën e njoftimit në lidhje me mbetjet.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr. 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, **në rast se** zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

### **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

**Konsultimi me publikun:** Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

### **3. Arsytet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

- Zhvillimi i aktivitetit, nuk prek zona të mbrojtura.
- Ky vendburim është ekzistues që prej vitit 1977

### **4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme.**

- 4.1** Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 4.2** Kjo deklaratë është e vlefshme pas miratimit nga institucionet përkatëse. Aktiviteti të zhvillohet vetëm brenda sipërfaqjes dhe koordinatave të kërkuara në aplikim.
- 4.3** Subjekti duhet të tregoj kujdes të veçantë me monumentet e natyrës të cilt ndodhen në zonë.
- 4.4** Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.

- 4.5 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.6 Subjekti të zbatojë me korrektësi kërkesat e Legjislacionit Shqipëtar për mbrojtjen e mjedisit dhe komunitetit.
- 4.7 Para fillimit të zbatimit të projektit në terren, të hartohet Plani i Menaxhimit Mjedisor.
- 4.8 Kompania të ndjek me përpikmëri projektin për të evituar rrëshkitjet e dherave dhe aksidentet e mundshme.
- 4.9 Proçesi teknologjik të kryhet në bazë të studimeve gjeologjike dhe hidrologjike për të shmangur në maksimum dëmtimin e burimeve ujore, devijimin e rrymave ujore, erozionin dhe dëmtimin e zonave përreth.
- 4.10 Proçesi i shpimit të pusit të mos dëmtojë vepra dhe infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe objekteve të tjera në afërsi, barriera mbrojtëse, tubacione ujësjellesi kanale etj.
- 4.11 Ndalohet kategorikisht shkarkimi i mbetjeve në shtratin e lumit në rast se gjenerohen të tilla.

#### **Gjatë fazës së instalimit:**

- 4.12 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore
- 4.13 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.14 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.15 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.16 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.17 Të sistemohen brenda sipërfaqjes së shfrytëzimit të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës
- 4.18 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.19 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.20 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- 4.21 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.22 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.

4.23 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.

4.24 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit nr. 60/2014 datë 19.6.2014, “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar, Shtojca I, duhet t’i nënshtrohet procedurave për paisje me Leje Mjedisore.

Në dokumentacionin për Leje Mjedisore subjekti duhet të japë informacion më të detajuar si më poshtë:

- Të qartësohen llojet e mbetjeve që gjenerohen, sasi të, kodet e tyre.
- Të jepen saktë distancat nga zonat e banuara
- Lidhur me shkarkimet në ajër dhe monitorimin e tyre
- Planin e Emergjencave, duke qënë se aktiviteti zhvillohet pranë qendrave të banuara

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**  
**EDISON KONOMI**

**MINISTRI**  
**BLENDI KLOSI**

